



Në bazë të nenit 46 alinea 2 të Ligjit për planifikimin dhe rregullimin e hapsirës (“Gazeta zyrtare e Kosovës” nr. 2/89), nenit 14, 39 dhe 40 të Ligjit mbi token ndërtimore (“Gazeta Zyrtare e Kosovës” nr.14/80), nenit 3 dhe 44 të Rregulloresë mbi Vetqeverisjen e Komunave të Kosovës nr.2000/45 dhe nenit 19 të Statutit të Komunës së Prishtinës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 03.04.2003 merr

**V E N D I M**  
**PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN-VENDOSJEN E**  
**OBJEKTIT TË QENDRËS REFERUESE EMERGJENTE TË BATALIONIT 40**  
**TË MJEKËSISË TË TRUPAVE MBROJTËSE TË KOSOVËS NË PRISHTINË**

**Neni 1**

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin-vendosjen e objektit për nevojat e Qendres Referuese Emergjente të Batalionit 40 të Mjekësisë të Trupave Mbrojtëse të Kosovës në Prishtinë.

**Neni 2**

Lokacioni për ndërtimin-vendosjen e objektit nga neni 1 i këtij Vendimi, caktohet pjesa e ngastrës kadastrale nr.2805/1 KK Prishtinë me sipërfaqe prej 0.70.00 ha.

**Neni 3**

Lokacioni nga neni 2 i këtij Vendimi i ipet TMK-së Qendrës Referuese Emergjente të Batalionit 40 të Mjekësisë në shfrytëzim të përkohshëm në kohëzgjatje prej 10 vitesh me mundësi të vazhdimit të kësaj të drejte edhe pas kalimit të afatit të caktuar.

**Neni 4**

Ky Vendim paraqet bazë për fillimin e projektit urbanistik për ndërtimin-vendosjen e objektit për nevojat e Qendrës Referuese Emergjente të Batalionit 40 të Mjekësisë të Trupave Mbrojtëse të Kosovës në Prishtinë.

**Neni 5**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i Drejtorëve të Komunës së Prishtinës. Drejtorati i Planifikimit, Urbanizimit dhe Ndërtimtarisë, Drejtoratit për Kadastër dhe Gjeodezi do të kryejnë veprime nga përgjegjësia e tyre e caktuar për realizimin e këtij Vendimi.

**Neni 6**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01.Nr. 353-507 Data 09.04.2003**

**KRYETARI I KUVENDIT**  
**Ismet Beqiri**